



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUŽILAČKI SAVET KOSOVA
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
ARKIVA - ARHIVA

03 -09- 2020

Nr./Br. 8M, 2020

PRISHTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës

Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më 21 korrik 2020, miratoi si vijon:

**PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR ZHVILLIM TË HETIMIT DHE
NDJEKJE PENALE TË TRAFIKIMIT TË NJERËZVE: KOORDINATORËT E
CAKTUAR PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE
NJERËZORE**

**Neni 1
Qëllimi**

- Secila prokurori do të caktojë prokurorët, të cilët do të specializohen në çështjet e trafikimit të njerëzve, në pajtim me dokumentet strategjike kombëtare kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Specializimi do të rrisë efikasitetin e hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të trafikimit të njerëzve përmes fuqizimit të mekanizmave dhe agjencive të zbatimit të ligjit. Caktimi i prokurorëve gjithashtu do të përmirësojë realizimin e Planit të punës së Prokurorit të Shtetit, i cili adreson në mënyrë specifike rritjen e numrit të ndjekjeve penale në rastet e trafikimit të njerëzve.
- Specializimi do të mundësojë qasje më profesionale, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për të rritur gjasat për ndjekje të suksesshme, ndërkohë që ndihmon edhe viktimat dhe siguron që trafikantëve të përgjigjen para drejtësisë.
- Koordinatorët e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore (tutje: Koordinatorët e TQNJs-së) do të trajtojnë rastet e trafikimit të qenie njerëzore (rastet e TQNJs-së) dhe do të shërbejnë për të unifikuar dhe bashkërenduar punën e prokurorëve dhe aktorëve të tjerë institucionalë dhe praktikat e ndryshme të parapara në legjislacionin në fuqi.

**Neni 2
Procesi i përzgjedhjes**

- Rekomandimet për procesin e përzgjedhjes përfshijnë caktimin e së paku një prokurori për rastet e trafikimit të njerëzve për secilin rajon.

2. Secili kryeprokuror cakton një prokuror, i cili shërben si koordinator për rastet e trafikimit të njerëzve dhe person kontaktues për atë rajon (koordinatori i TQNJ-së). Secila prokurori pas shqyrtimit të statistikave përkatëse mund ta shqyrtojë mënyrën më efikase dhe efektive për t'i bartur përgjegjësitë te koordinatorët e TQNJ-së, bazuar në nevojat e zyrës dhe ngarkesës me lëndë të trafikimit të njerëzve.
3. Nëse në një prokurori ka numër më të vogël të rasteve të trafikimit të njerëzve, kryeprokurori i asaj prokurorie të gjitha rastet e trafikimit të njerëzve do t'ia ngarkojë koordinatorit të TQNJ-së dhe, njëkohësisht, të njëjtit do të mund t'i caktohen lëndë të natyrave të tjera.
4. Në prokuroritë e regjioneve ku ka numër më të madh të rasteve të trafikimit të njerëzve, rastet e TQNJ-së do t'u caktohen edhe prokurorëve të tjerë, të cilët lidhur me rastin do të konsultohen me koordinatorin përktaës të TQNJ-së të prokurorisë.
5. Veprat penale të trafikimit të njerëzve që bien në kategorinë e veprave që trajtohen nga Departamenti për të Mitur do të vazhdojnë të trajtohen nga prokurorët për të mitur. Përjashtimisht në Prokurorinë Themelore të Prishtinës do të caktohet një koordinator i TQNJ-së në Departamentin për të Mitur.
6. Përzgjedhja e koordinatorit të TQNJ-së për secilën prokurori përkatëse bëhet nga kryeprokurori. Përshtatshmëria e kandidatit për pozitën e koordinatorit të TQNJ-së do të jetë thelbësore me rastin e përzgjedhjes në këtë detyrë. Cilësitë e kandidatit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto si në vijim:
 - 6.1 Zotëron aftësi të forta ligjore dhe analitike;
 - 6.2 Është në gjendje të punojë mirë më njerëzit në komunitet;
 - 6.3 Të ketë aftësi të mira organizative, të jetë energjik dhe i vetëmotivuar;
 - 6.4 I gatshëm për të marrë qasje proaktive ndaj rasteve të TQNJ-së;
 - 6.5 I aftë për ta koordinuar punën me zbatuesit e ligjit, përfshirë koordinimin e përpjekjeve të palëve të interesuara, punën e kontaktimit dhe informimit të komunitetit, kriteret dhe mundësitetë e trajnimit.
7. Gjatë përzgjedhjes, kujdes i veçantë do t'i kushtohet:
 - 7.1 Historikut, trajnimit dhe përvojës në trajtimin e viktimave, veçanërisht viktimave të ndjeshme;
 - 7.2 Përvojës në trajtimin e rasteve të trafikimit të njerëzve;
 - 7.3 Përvojës të punës për së afërm me hetuesit, mbrojtësit e viktimave dhe aktorët e tjerë;
 - 7.4 Gatishmërisë dhe vullnetarizmit për t'u caktuar si koordinator i TQNJ-së dhe trajtimit të rasteve të trafikimit të njerëzve.
8. Gjatë caktimit të koordinatorëve të TQNJ-së duhet të merren në konsideratë edhe çështjet si vijojnë:

- 8.1 Prioritizimi i rasteve të TQNJ-së do të kërkojë disponueshmëri më të madhe në mënyrë që të veprohet shpejtë në përpilimin e raporteve dhe pranimin e ofrimin e trajnimeve, koordinimin e aktorëve, raportime, kryesimin dhe organizimin e takimeve me aktorë dhe mbajtjen e statistikave.
- 8.2 Rastet që përfshijnë intervistimin e të gjithë dëshmitarëve dhe koordinimi i institucioneve të ndryshme kërkojnë punë intensive dhe marrin shumë kohë.
9. Në rastet kur prokurori i caktuar si koordinatori i TQNJ-së lëviz në ndonjë departament tjeter apo prokurori tjeter, kryeprokurori do të bëjë zëvendësimin e menjëhershëm të pozitës së koordinatorit me kandidatin me të përshtatshëm në atë prokurori sipas procedurës së njëjtë.
 10. Pas përzgjedhjes së prokurorëve nga kryeprokurorët, lista përfundimtare e koordinatorëve të TQNJ-së i dërgohet Këshillit Prokurorial për njoftim.

Neni 3 Trajnim i dhe profilizimi i prokurorëve

1. Koordinatori i TQNJ-së është përgjegjës për arritje të njojurive të ligjeve që adresojnë trafikimin e njerëzve, përfshirë Ligjin për pàandalimin dhe luftimin e trafikimit të njerëzve dhe mbrojtjen e viktimate të trafikimit, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Është gjithashtu e domosdoshme që prokurori të ketë qasje të mirinformuar mbi format e trafikimit të njerëzve, indikatorët për identifikimin e hershëm të viktimate të trafikimit të njerëzve, nevojat e viktimate dhe të drejtat e viktimate sipas dokumenteve dhe ligjeve në fuqi.
2. Koordinatori i TQNJ-së duhet t'i njohe procedurat dhe rolet e të gjitha aktorëve në mënyrë që të sigurojë bashkërendim të mirëfilltë dhe shkëmbim informacioni. Aktorët përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: Policinë e Kosovës, mbrojtësit e viktimate, shërbimet sociale, strehimoret dhe Shërbimin Sprovues.
3. Koordinatori i TQNJ-së i nënshtronhet trajnimit të specializuar të trafikimit të njerëzve dhe veprat që ndërlidhen me to.
4. Prokurori për të mitur i ngarkuar për trajtimin e rasteve të TQNJ-së vijon gjithashtu trajnime të specializuara së bashku me koordinatorët e TQNJ-së.
5. KPK-ja në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë do të mundësojnë realizimin e trajnimeve të specializuara dhe azhurnimin e tyre.
6. Koordinatori i TQN-së mund të vijojë edhe trajnime të specializuara edhe jashtë vendit me pëlqimin e kryeprokurorit.

7. Rekomandohen trajnime të përbashkëta në të cilat të gjithë aktorët ta kenë mundësinë për të ofruar trajnime për njëri-tjetrin lidhur me strategjitë ose teknikat e reja për rastet e TQNJ-së.

Neni 4 **Caktimi dhe menaxhimi i rasteve**

1. Të gjitha rastet që përfshijnë trafikimin e njerëzve do të registrohen përmes SMIL-it dhe do t'i caktohen prokurorit të caktuar si koordinator për TQNJ në secilën prokurori, në përputhje me Rregulloren e KPK-së për administrimin dhe ndarjen e lëndëve në Prokurorinë e Shtetit (Rregullorja 02/2019), përkatësisht në dispozitat që i referohen ndarjes manuale të lëndëve dhe ndarjes së lëndëve të pranuara gjatë kujdestarisë.
2. Kur prokurori kujdestar pranon thirrje për një rast të trafikimit të njerëzve, ai/ajo konsultohet me koordinatorin e TQNJ-së dhe nëse është e nevojshme, ky i fundit punon së bashku me prokurorin kujdestar dhe policinë për hapat fillestarë që duhen ndërmarrë, pasi ata janë në pozitën më të mirë për të parashikuar nevojat për ndjekjeje të suksesshme penale.
3. Koordinatorët e TQNJ-së, të cilëve u caktohen rastet e trafikimit të njerëzve, do të janë përgjegjës për të ndërmarrë të gjitha veprimet në kuadër të kompetencave të tyre, duke adresuar edhe kompensimin e dëmit në të gjitha rastet e trafikimit të njerëzve.
4. Koordinatori i TQNJ-së ruan dhe ndërlidh informacionet për çdo kryerës dhe viktimë për rastet e tjera, përfshirë rastet e trafikimit në të kaluarën dhe procedurat paraprake.
5. Koordinatori i TQNJ-së do të bëjë përpjekje për t'i proceduar në mënyrë të tërsore dhe azhuritet të gjitha rastet e trafikimit të njerëzve për të siguruar zgjidhje të shpejtë dhe për të shmangur vazhdimin e shfrytëzimit ose rrezikun për viktimen.
6. Rastet e TQNJ-së që përfshijnë fëmijë viktima të trafikimit do të përcaktohen dhe trajtohen nga prokurorët për të mitur në Departamentin për të Mitur. Rastet që përfshijnë fëmijë duhet të trajtohen në përputhje me kornizën ligjore ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve.
7. Koordinatorët e TQNJ-së do të trajtojnë rastet e trafikimit të njerëzve dhe veprat penale të tjera të trafikimit të njerëzve në bazë të Kodit Penal të Kosovës në fuqi siç janë renditur më poshtë¹:

¹ Veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, sipas Kodit Penal të Kosovës që ka qenë në fuqi nga data 1 janar 2013 deri me datën 14 prill 2019 përfshijnë:

I) Neni 169: "Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar";

- 7.1 Neni 163: Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërimë dhe puna e detyruar;
- 7.2 Neni 165: Trafikimi i njerëzve;
- 7.3 Neni 166: Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit të njerëzve;
- 7.4 Neni 228: Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit;
- 7.5 Neni 239: Martesa e detyruar - nëse ka elemente të trafikimit të njerëzve;
- 7.6 Neni 259: Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore.

Neni 5

Bashkëpunimi me mbrojtësit e viktimave dhe qasja me viktimën në qendër për trajtimin e rasteve të TQNJ-së

1. Koordinatorët e TQNJ-së do të qëndrojnë në komunikim dhe koordinim të ngushtë me mbrojtësit e caktuar të viktimave për të siguruar që viktimat të informohen për të drejtat e tyre themelore dhe mbështetjen gjatë fazës së hetimit, procedurës paraprake dhe procesit gjyqësor në sistemin e drejtësisë penale.
2. Koordinatorët e TQNJ-së i përmbahen "Listës së treguesve për identifikim formal të viktimave të trafikimit" para se të identifikojnë një person si viktimë të trafikimit?
3. Koordinatori i TQNJ-së ka për detyrë të sigurojë që janë ndërmarrë vlerësimet përkatëse të rrezikut, në mënyrë që të mund të merren veprime të duhura për të mbrojtur viktimat, përfshirë kërkimin e masave specifike mbrojtëse të parapara në Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në konsultim me mbrojtësin e viktimave dhe viktimën. Siguria e viktimave dhe familjeve të tyre është thelbësore gjatë gjithë kohës dhe është përgjegjësi e hetuesit dhe prokurorit.

-
- 2) Neni 171: "Trafikimi i njerëzve". Vepra penale "Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet", që ishte parashikuar më Kodin e vjetër Penal të vitit 2012 nga neni 235, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, tanë me Kodin e ri nuk parashihet si vepër penale e veçantë, por kjo është përfshirë te neni 165, paragrafi 2, ku si viktima të trafikimit janë të gjitha viktimat që janë nën moshën 18-vjeçare.
 - 3) Neni 172: "Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit të njerëzve",
 - 4) Neni 231 "Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit",
 - 5) Neni 235 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2 nenparagrafi 2.2 "Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet",
 - 6) Neni 265 "Transplantimi i kundërligjshëm dhe trafikimi i organeve dhe qelizave njerëzore",
 - 7) Neni 246 "Martesa e detyruar" - Nëse ka elemente të trafikimit me njerëz.

² Udhëzimi administrativ QRK Nr.10/2017 për listën e treguesve për identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit me njerëz. Shih <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E744437D-135A-477B-8FF4-37FAB8034189.pdf>

4. Përveç vlerësimit të rrezikut për sigurinë fizike të viktimit, një vlerësim gjithëpërfshirës i rrezikut duhet ta marrë parasysh edhe dëmin psikologjik dhe/ose fizik që ka pësuar viktima.
5. Shumica e viktimate të trafikimit janë gra ose fëmijë. Gjatë trajtimit të të gjitha rasteve të TQNJ-së duhet të kihet qasje e ndjeshme ndaj aspekteve gjinore me të gjithë viktimat, dhe pavarësisht nga gjinia ato trajtohen në mënyrë të barabartë.
6. Nëse viktimat nuk ndjehen rehat me prokurorin e rastit për shkak të çështjeve specifike që ndërlidhen me gjininë e prokurorit, kur është e mundur, mund të kërkohet ndihmë nga prokurori i gjinisë së kundërt për të zhvilluar intervistë me viktimin.
7. Koordinatorët do të jenë në kontakt me punonjësit përkatës socialë për të siguruar që viktimat dhe familjet e tyre të pranojnë trajtimin e duhur dhe shërbimet e mbështetjes në dispozicion. Koordinatorët e TQNJ-së do të punojnë ngushtë me qendrat për punë sociale për të identifikuar nevojat specifike të viktimate të trafikimit, të cilat mund të kenë nevoja urgjente shëndetësore, përfshirë nevoja psikologjike, fizike dhe nevoja të shëndetit riprodhues dhe seksual, që mund të kërkojnë trajtim dhe kujdes të specializuar.
8. Koordinatorët e TQNJ-së do të sigurojnë që viktimat të jenë të azhurnuara me informata rreth rrjedhës së hetimit dhe përpjekjeve të prokurorisë, në mënyrë që të minimizohet trauma dhe rivictimizimi.
9. Koordinatorët e TQNJ-së sigurojnë që viktima të njoftohet lidhur me masat për sigurimin e pranisë së pandehurit dhe të adresojë çështjen e sanksionit penal ndaj të pandehurit.
10. Koordinatorët në bashkëpunim me mbrojtësit e viktimate sigurohen që viktimat të jenë të njoftuara për procesin e dëmshpërblimit nga i pandehuri dhe mundësitetë për kompensim nga shteti në pajtim me Ligjin për kompensimin e viktimate të krimít.
11. Koordinatori siguron që edhe palët e interesuara relevante dhe viktima të mbahen të informuar për procedurat e rasteve, në veçanti për procedurën për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Neni 6

Koordinimi me zbatuesit e ligjit për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të TQNJ-së

1. Koordinatorët e TQNJ-së do të koordinohen me hetuesit e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore (DHTQNJ) për të siguruar që ata do të informojnë koordinatorët e TQNJ-së për rastet në fillim të hetimeve të tyre. Kjo do të sigurojë

që janë ndërmarrë veprimet e duhura hetimore për të ndihmuar në rritjen e gjasave për ndjekje penale të suksesshme të këtyre rasteve.

2. Koordinatorët e TQNJ-së sigurojnë që për intervistimin e viktimate dhe hetimin e rasteve të trafikimit të njerëzve të jenë të përfshirë hetuesit e specializuar të Policisë së Kosovës nga DHTQNJ-ja dhe të jenë në koordinim të ngushtë me ata hetues. Ekipi i intervistimit është multidisiplinar dhe ndiqen e zbatohen procedurat standarde të veprimit për identifikimin e viktimate të trafikimit dhe standardet minimale për trajtimin e viktimate të trafikimit të njerëzve.
3. Mund të ndiqen praktikat e mira duke pyetur viktimat nëse kanë preferenca në lidhje me gjininë e policëve hetues përgjegjës për intervistimin e tyre, si dhe ofruesve të shërbimeve që ndihmojnë drejtpërdrejt viktimat. Nuk duhet të supozohet se viktimate duhet t'iu caktohen persona të së njëjtës gjini. Në vend të kësaj, kurdo që të jetë e mundur dhe të kërkohet nga viktimat, atyre duhet t'iu caktohen hetues të së njëjtës gjini.
4. Vlerësimi i rezikut dhe aranzhimet për masat e duhura të mbrojtjes së viktimate duhet të bëhen nga policia në bashkëpunim me prokurorët e TQNJ-së;
5. Koordinatorët e TQNJ-së sigurohen që hetuesit e DHTQNJ-së mbrojnë mireqenien e viktimate, duke u lidhur me aktorët kryesorë, siç janë mjekët, psikologët, ofruesit e shërbimeve sociale dhe ofruesit e përkrahjes së viktimate për të siguruar qasje në shërbimet e ndihmës së drejtpërdrejtë, si: strehimoret, këshillimi dhe ndihma mjekësore, duke i bërë referimet e nevojshme.
6. Koordinatorët e TQN-së do t'i udhëzojnë hetuesit e DHTQNJ-së për ndërmarrjen e hetimeve penale, duke siguruar bazë të qartë të provave për secilën pikë të akuzës. Provat e mbledhura duhet të përqendrohen në vërtetimin e veprës, mjeteve dhe qëllimit të shfrytëzimit, duke u mbështetur në elementet nga përkufizimi i trafikimit të njerëzve në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.
7. Koordinatorët e TQNJ-së do të sigurojnë që policia e DHTQNJ-së të konsultohet me prokurorin përpara se t'i intervistojë viktimat dhe të jetë në komunikim dhe konsultim të vazhdueshëm me policinë gjatë komunikimit me viktimat.
8. Hetuesit e DHTQNJ-së dhe koordinatorët e TQNJ-së do të kryejnë hetimet e nevojshme për të identifikuar viktimat e trafikimit, përfshirë dhe hetimet proaktive. Policisë dhe prokurorëve mund t'iu duhet të mbështeten kryesisht në dëshminë e viktimate dhe gjithash tu të ndërmarrin metoda të tjera hetimi për të ndjekur rastet. Në hetime proaktive, DHTQNJ-ja është e detyruar të bashkëpunojë me koordinatorët e TQNJ-së dhe të mos varet vetëm nga dëshmia ose bashkëpunimi i viktimës; në vend të kësaj duhet të mbështeten në përdorimin e një kombinimi të mjeteve për të mbledhur prova dhe ndërtuar rrëthana për ta ndihmuar ndjekjen penale. Megjithëse rastet e trafikimit ndiqen më lehtë kur viktimat bashkëpunojnë me zbatuesit e ligjit, bashkëpunimi në rastet e TQNJ-së në përgjithësi mund të jetë

më i kufizuar në krahasim me bashkëpunimin e viktimateve të veprave të tjera penale. Kjo mund të ndodh për një sërë arsyesh përfshirë përvojës traumatike si pasojë e të trafikimit, e cila shpesh i bën viktimat më pak të besueshme, të paafta ose jo të gatshme për t'u përfshirë në proces, veçanërisht menjëherë pas ngjarjes.

9. Koordinatorët e TQN-së duhet të punojnë për të ndërtuar rastet përmes një qasjeje proaktive për të gjetur burime të ndryshme të provave të forta në vend se të mbështeten vetëm në dëshmitë/deklarata e dëshmitarëve. Për shkak të natyrës së veprës penale, traumës së përjetuar dhe frikës së hakmarrjes nga trafikuesit, ka shumë raste kur viktimat që më parë kanë bashkëpunuar me autoritetet, vendosin të mos i bashkëngjiten ndjekjes penale. Sa më i mirë të jetë sistemi i mbështetjes, mbrojtjes dhe asistencës që u ofrohet viktimate, aq më shumë ka të ngjarë që ato të marrin pjesë në përpjekjet e zbatuesve të ligjit.
10. Koordinatorët e TQNJsë duhet të bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet e tyre edhe me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) në rastet kur zyrtarët policorë janë të përfshirë si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të trafikimit të njerëzve.
11. Veprimet e përshkruara në këtë nen dhe në nenet e tjera relevante i referohen rasteve kur lëndët e TQNJsë i caktohen për trajtim koordinatorit të TQNJsë. Në të gjitha rastet e tjera kur lëndët e TQNJsë trajtohen nga prokurorët e tjere, prokurori i rastit merr veprimet e mësipërme dhe sipas nevojës në çdo kohë mund të konsultohet dhe koordinohet me koordinatorët e TQNJsë.

Neni 7 **Procedurat gjyqësore**

1. Koordinatorët e TQNJsë do të koordinohen me Policinë dhe mbrojtësit e viktimate për t'i përgatitur viktimat për gjykim. Prokurori dhe/ose mbrojtësi i viktimate, nëse është e nevojshme ua mundësojnë viktimate që ta vizitojnë gjykatoren për t'ua mundësuar atyre familjarizimin me të dhe për të ndihmuar në përgatitjen e tyre mendore.
2. Koordinatorët e TQNJsë do t'ua sqarojnë viktimate me kujdes procesin e gjykimit, duke siguruar që ato të kuptojnë plotësisht se çka të presin kur janë në gjykatoren, duke përfshirë edhe mundësinë që t'i shmanget kontakti me të pandehurin.
3. Koordinatorët e TQNJsë do të sigurohen që të merren në konsideratë masat e sigurisë, të ndiqen protokollet përkatëse dhe që gjatë gjykimit të jenë të vendosura masat e duhura të sigurisë.
4. Koordinatorët e TQNJsë duhet ta kontrollojnë gatishmërinë e viktimës për të dëshmuar dhe të përcaktojnë se cilat masa të veçanta janë të nevojshme për ta zvogëluar traumën gjatë dhënies së dëshmisë.

5. Koordinatorët e TQNJ-së do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kërkesës së viktimës për dëmshpërblim dhe do të udhëzojnë për po të njëjtën gjë edhe prokurorët e tjerë që merren me raste të TQNJ-së.
6. Koordinatorët e TQNJ-së për rastet që janë në trajtim do të kërkojnë gjithnjë nëse ka potencial për konfiskim të pasurisë së paligjshme, duke sugjeruar kurdo që është e mundshme propozimin e shitjes së aseteve të konfiskuara për adresimin e dëmshpërblimit të viktimate të trafikimit.

Neni 8 Koordinimi dhe bashkëpunimi

1. Koordinatori i TQNJ-së do të jetë personi koordinues për ndjekjet penale të lidhura me trafikimin e njerëzve dhe do të jetë në kontakt të vazhdueshëm me mbrojtësit e viktimate, hetuesit e DHTQNJ-së, Shërbimin Sprovues, strehimoret dhe shërbimet sociale, në mënyrë që të përmirësojnë rrjedhën e informacionit dhe të sigurojnë që koordinatori i TQNJ-së është plotësisht i vetëdijshëm për të gjitha të dhënat e rëndësishme për rastet konkrete dhe palët e përfshira.
2. Koordinatorët e TQNJ-së duhet të organizojnë takime të rregullta tremujore për të bashkuar në një vend të gjithë aktorët (Policinë e Kosovës, mbrojtësit e viktimate, strehimoret, shërbimet sociale, shërbimet juridike falas, Shërbimin Sprovues, etj.) në mënyrë që t'i diskutojnë jo vetëm rastet specifike që kanë nevojë për qasje të koordinuar, por edhe praktikat e mira, në përpjekje për të mbajtur komunikimin e hapur dhe për të krijuar marrëdhënie të forta me partnerët.
3. Koordinatorët e TQNJ-së duhet të angazhohen edhe për koordinimin me Gjyqësorin për të siguruar prioritizimin e rasteve para këtij institucioni.
4. Koordinatorët e TQNJ-së në të gjithë vendin duhet të takohen me Koordinatorin e TQNJ-së në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në baza gjashtëmujore për të diskutuar praktikat e mira dhe për të koordinuar përpjekjet për të siguruar trajnime, komunikim me komunitetin dhe takime të palëve të interesit për të ndihmuar në sigurimin e një qasjeje të njëtrajtshme ndaj ndjekjeve penale të TQNJ-së në të gjithë vendin. Koordinatorët e TQNJ-së duhet të kenë një vizion për trajtimin e çështjeve të TQNJ dhe të kërkojnë avancim të metodave për ndjekjen penale më efektive, duke zbatuar strategji të reja kurdo që është e mundshme dhe e nevojshme.

Neni 9 Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ekipet e përbashkëta të hetimit

1. Bashkëpunimi ndërkombëtar është faktor thelbësor në luftën kundër veprave të TQNJ-së që përfshin aktivitete ndërkufitarë.
2. Koordinatorët e TQNJ-së do të punojnë me DHTQNJ-së dhe do të zbatojnë protokollet e nënshkruara ndërmjet shteteve të rajonit apo dhe shteteve të tjera për

unifikimin e identifikimit dhe referimit të viktimave të trafikimit, veçanërisht fëmijëve viktima të trafikimit të njerëzve.

3. Koordinatorët e TQNJ-së duhet të punojnë së bashku për të parandaluar, hetuar, ndjekur, gjykuar dhe dënuar kryerësit e veprës penale të trafikimit të njerëzve. Kuadri ligjor gjithëpërfshirës është përvjuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimtit të organizuar, Protokollin shtesë të Palermos për TQNJ dhe rregullativën e BE-së.
4. Koordinatorët duhet të veprojnë me urgjencë në rastet kur viktimat janë të huaja si dhe rastet kur ato kërkojnë riatdhesim në vendin e tyre.
5. Kur viktimat janë të huaja, koordinatorët e TQNJ-së duhet të njoftojnë viktimat përmundësinë e kompensimit nga shteti në rast të mosmundësisë së realizimit të dëmshpérblimit nga i pandehuri. Viktimave që kthehen në vendet e tyre të origjinës, u bëhet e ditur se kompensimi mund të realizohet përmes autoriteteve përgjegjëse në pajtim me Ligjin për kompensimin e viktimave të krimtit.

Neni 10 **Mbledhja e të dhënave dhe raportimi**

1. Koordinatorët e TQNJ-së janë përgjegjës përmes sistemit SMIL) për rastet e tyre përkatës, në mënyrë që të kuptojnë më mirë trendët dhe implikimet e trafikimit të njerëzve. Statistikat përfshijnë numrin e rasteve penale të iniciuara, veprimet e prokurorëve në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve, përfshirë numrin e aktakuzave dhe epilogun e rasteve.
2. Këto të dhëna ruhen rregullisht për secilin rajon dhe pasqyrohen në mekanizmat e përgjithshëm të raportimit të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Të dhënat mbahen përmes qëllime të politikave dhe programimit dhe ofrojnë të dhëna përmes analizimin e trendit dhe mund të reflektohen në raporte të ndryshme që përdoren përmes qëllime të brendshme dhe publike.
3. Koordinatorët e TQNJ-së i raportojnë në baza tremujore koordinatorit të TQNJ-së në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, i cili edhe e përfaqëson Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në Autoritetin Kombëtar Kundër Trafikimit të Njerëzve. Raportimi do të bëhet në bazë të formatit të raportimit, të përpiluar nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.
4. Koordinatori i TQNJ-së nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit do të raportojë në baza tremujore lidhur me rastet e TQNJ-së në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Autoritetin Kombëtar Kundër Trafikimit të Njerëzve.

Neni 11 **Hyrja në fuqi**

Ky akt nënligjor hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 21 korrik 2020



Kryesues i Këshilli Prokurorial të Kosovës